



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Histori e Mbretërisë së Bashkuar

Ngarkesa: 4 kredite, 20 orë leksione, 20 orë seminare

Viti / Semestri : Viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhën Angleze

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 5, 6, 7)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva te përgjithshme lëndore: Zgjerimi i njohurive historike – Të pajisë studentët me njohuri të thella mbi zhvillimin politik, social dhe ekonomik të Mbretërisë së Bashkuar. Nxitja e angazhimit dhe të menduarit kritik – Të inkurajojë pjesëmarrjen aktive në seminare dhe krahasimin e ngjarjeve britanike me ato shqiptare. Promovimi i qasjes logjike ndaj studimit – Të udhëzojë studentët të studiojnë materialin në mënyrë të strukturuar, duke shmangur mësimin mekanik e përsëritës.

Objektivat specifike lëndore:

1. Analizë shkak–pasojë – Të zhvillojnë aftësinë për të identifikuar dhe interpretuar lidhjet shkak–pasojë në ngjarjet kryesore historike britanike.
2. Studim i ndryshimit dhe vazhdimësisë – Të dallojnë fazat e ndryshme dhe elementët e vazhdueshëm në histori, nga monarkia e hershme deri te Komonuelthi.
3. Krahasim i ngjashmërive dhe ndryshimeve – Të përcaktojnë pikat e përbashkëta dhe dallimet midis zhvillimeve britanike dhe atyre në Shqipëri.

Rezultatet e pritshme :

1. Panoramë e plotë historike – Studentët do të zotërojnë një pasqyrë kronologjike të fazave kryesore të historisë britanike, duke përfshirë dimensionet politike, sociale dhe ekonomike.
2. Zhvillim i të menduarit kritik – Studentët do të demonstrojnë aftësi për të nxjerrë përfundime logjike dhe të mbështetura në prova shkencore.
3. Produktivitet akademik – Studentët do të përgatisin detyra kursi të strukturuar, me analizë të thelluar mbi tema politike, sociale dhe kulturore të Mbretërisë së Bashkuar dhe Komonuelthit.